**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA MALLAKASTËR**
**KRYETARI**

Nr. 4154 prot. Ballsh më, 22 . 08 .2024

**PROJEKT - VENDIM**

**Nr. 28 Datë 22 / 08 / 2024**

**"PËR DHËNIE TË TITULLIT QYTETAR NDERI PËR Z. ÇELO BORAJ"**

Në bazë të nenit 113 të Kushtetutës së Rebublikës së Shqipërisë, të Ligjit 139/2015, neni 54, pika m "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr. 112/2013, neni 15 "Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë", shkresës me nr. 539 prot., datë 05.02.2024 "Kërkesë / Propozim për dhënie titull qytetar nderi" të Shoqatës Patriotike Kulturore Mallakastra, shkresës me nr. 1309/1 prot., datë 26.04.2024 "Kërkesë për informacion mbi pastërtinë e figurës", drejtuar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentin e ish Sigurimit të Shtetit", shkresës me nr. 710/3 prot., datë 17.05.2024 "Informim mbi rezultatin e verifikimit të pastërtisë për kandidatin e propozuar për marrjen e titullit të nderit", relacionit me nr. 4141 prot., datë 21.08.2024 të Komisionit këshillimor për dhënien e titujve të nderit, ngritur me Urdhërin e Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër nr. 126, datë 16.04.2024,

**PROPOZOJ**

I- Dhënien e titullit "Qytetar Nderi", Çelo Ramadan Boraj.

II- Motivacioni I dhënies së Titullit "Qytetar Nderi", Z. Çelo Boraj: Bir i nderuar i Mallakastrës i cili duke kryer detyra të larta në fushën ushtarake, ka nderuar personalitetin e tij, Mallakastrën dhe gjithë Shqipërinë.

III-

**Specialist**
A.Heqimaj

**P / Sektori Juridik**
N. Sakaj

**KRYETAR**

**Qerim Ismailaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALLAKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALLAKASTËR**
KABINETI KRYETARIT
PROTOKOLL/SEKRETARIA

# KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

**Dërgues** Shoqata Atdhetare Kulturore Mk. **Nr.prot.**______ **Data** 24.01.2024

**Shkurtimi i lëndës:** Kërkesë, propozim për dhënie titulli

| | |
|---|---|
| **Për trajtim nga:** | Sek KOSHOLLIT |
| Struktura të tjera të ngarkuara | Drejt B. N. Juridike |
| Me porosi | |

**Afati:**

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Normal (7 ditë) | | Prioritet (3 ditë) | | Urgjent (brenda ditës) | | Pa afat / për dijeni | | Tjetër ___ ditë |

**Data** 05.02.2024, **Nr. prot** 539 **Nënshkrimi (TITULLARIT)**______

**Marrë në dorëzim** ___.___.**2024.** **Drejtori: Nënshkrimi**______
**Kalon për trajtim (struktura):** ______ ___.___.**2024.**
**Me porosinë:** ______

**Marrë në dorëzim** ___.___.**2024.** **Përgjegjësi: Nënshkrimi**______
**Kalon për trajtim (struktura):** ______ ___.___.**2024.**
**Me porosinë:** ______

**Marrë në dorëzim** ___.___.**2024.** **Specialisti: Nënshkrimi**______
**Kalon për trajtim (specialistit):** ______ ___.___.**2024.**
**Me porosinë:** ______

**Trajtimi i materialit përfunduar më:** ___.___.**2024,** **Sp.**______
**Trajtimi i materialit pranuar më:** ___.___.**2024,** **Përgj.**______
**Trajtimi i materialit miratuar më:** ___.___.**2024,** **Drejt.**______
**Trajtimi i materialit konfirmuar më:** ___.___.**2024,** **Dr.Kabineti**______

Adresa: Lagja 18 Prilli Ballsh Mallakastër Tel: +355 313 23493, posta elektronike: ballshi@bashkiamallakaster.gov.al, faqja zyrtare: www.bashkiamallakaster.gov.al

PROTOKOLLI
Nr. 539
Dt. 05/02/2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQATA ATDHETARE KULTURORE MALLAKASTRA

## KËRKESË, PROPOZIM

Drejtuar: BASHKISË MALLAKASTËR,
KËSHILLIT BASHKIAK MALLAKASTËR,

Lënda: Kërkesë, propozim për dhënie titulli Qytetar Nderi

I nderuar Kryetar i Bashkisë !
I nderuar Kryetar i Këshillit Bashkiak !
Shoqata Atdhetare Kulturore MALLAKASTRA, duke vlerësuar rolin, kontributin rajonal dhe kombëtar të zotit **Çelo Ramadan BORAJ**, ushtarak madhor, bir i nderuar i Mallakastrës, anëtar i Kryesisë së Shoqatës Atdhetare Kulturore MALLAKASTRA, Ju propozon dhënien e titullit,

Qytetar Nderi i Mallakastrës

me motivacionin si më poshtë:

**Bir i nderuar i Mallkastrës, ushtarak madhor i cili duke kryer detyra të larta si komandant Brigade, Divizioni, Korpusi, nga jugu në veri të atdheut tonë, ka nderuar personalitetin e tij, Mallakastrën dhe gjithë Shqipërinë.**

Punë të mbarë për krahinën tonë dhe vlerësimin e personaliteteve të ndritura mallakastriote.

KRYETARI
Av.IDAJET BEQIRI

Tiranë 24. 01. 2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQATA ATDHETARE KULTURORE MALLAKASTRA

# JETËSHKRIMI

## ÇELO RAMADAN BORAJ

| Periudha, Koha | Historiku (Datëlindja, Arsimimi, Detyrat, Punësimi) |
|---|---|
| 08. 05. 1943 | Vendlindja Romës, Mallakastër. |
| 1951-1957 | Shkolla 7 Vjeçare "Sotir Koçi" Selenicë, Vlorë. |
| 1957-1960 | Shkolla e Mesme "Hajredin Beqari", Selenicë, Vlorë. |
| 1960-1963 | Shkolla e Bashkuar e Oficerave "Enver Hoxha", Tiranë Grada "Toger" |
| 1963-1967 | Brigada e 6-të e Këmbësorisë, Përmet me detyra (Komandant Toge, Zv. Kom./Kompanie, Komandant Batalioni në Buz, Tepelenë, shef stërvitjeje në Brigadë) |
| 1967-1969 | Akademist në Akademinë e Lartë Ushtarake "Mehmet Shehu", Tiranë, me rezultate të Shkëlqyera. |
| 1969-1972 | Shef i Degës Operative të Korpusit të II-të, Gjirokastër. |
| 1972-1976 | Shefi Shtabit të Korpusit të II-të, Gjirokastër. |
| 1976-1977 | Student në Shkollën e Lartë të Filozofisë, Tiranë. |
| 1977-1982 | Shefi Shtabit të Korpusit të V-të, Pukë. |
| 1983-1989 | Komandant i Divizionit të 17-të, të Këmbësorisë (Tropojë, Kukës Pukë. |
| 1989-1992 | Shef i Sektorit të Gatishmërisë, në Ministrinë e Mbrojtjes, në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe në Këshillin e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë. |
| 1992-1998 | Në reformë i pa trajtuar financiarisht. |
| 1998-2017 | Administrator "Shoqëria Private e Sigurisë, Erlindi-2000", për ruajtjen me Truprojë Shërbimi, dhe Ruajtje Objektesh të kompanive private "Deka Kompani", "Sigali" dhe objekte të tjera. |

## DEKORATAT

| | |
|---|---|
| 1969 | Urdhëri "Ylli Kuq i Klasit të Parë" |
| 1972 | Urdhëri "I Skënderbeut i Klasit të Parë" |
| 1976 | Medalje "Për Shërbime të Shquara në Fushën e Mbrojtjes" |
| 1970 | Medalje e Karrierës, "Për shërbimin Ushtarak" |

Celular: 0692077019
Tiranë 24. 01. 2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALLAKASTËR**

**KRYETARI**

Nr. 1309/1 prot.  Ballsh, më 26.04.2024

Lënda: Kërkesë për informacion mbi pastërtinë e figurës

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

*Adresa: Njësia Administrative nr. 4, Rruga e Dibrës, Garnizoni Skënderbej*

**TIRANË**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr. 94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", shkresës tuaj nr. 480 Prot., datë 25.03.2024 "Kërkesë për bashkëpunim në zbatim të rekomandimit të Avokatit të Popullit, referuar shmangies së përdorimit dhe emërtimit të rrugëve, sheshevë dhe hapësirave publike me data dhe simbole që lidhen me të kaluarën e regjimit komunist", administruar pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 1309 Prot., datë 27.03.2024, shkresës me nr. 539 Prot., datë 05.02.2024 "Kërkesë për propozim", i Shoqatës Atdhetare Kulturore Mallakastra, për dhënie titull nderi Z. Çelo Ramadan Boraj, ju drejtohemi më anë të kësaj shkrese në lidhje me:

Informacion, nëse ekzistojnë informacione në dokumente të ish sigurimit të shtetit pranë institucionit tuaj, ne emër të Z. Çelo Ramadan Boraj.

**Në bashkëpunim me ju!**

**Komisioni**

Rajmonda Veizaj

Burbuqe Shehaj

Naime Dervishaj

Zinaida Ahmetaj

Jonida Llaka

**KRYETAR**

**Qerim Ismailaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALLAKASTËR

Adresa: Lagja 18 Prilli Ballsh Mallakastër Tel: +355 313 23493, posta elektronike: ballshi@bashkiamallakaster.gov.al, faqja zyrtare. ëëë.bashkiamallakaster.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR
KABINETI KRYETARIT
PROTOKOLLI

# KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

**Dërgues** Autoriteti për Info. Tr **Nr.prot.** 710/3 **Data** 17.05.2024

**Shkurtimi i lëndës:** Informim mbi rezultatin e verifikimit...

| **Për trajtim nga:** | |
|---|---|
| Struktura të tjera të ngarkuara | Dr.jt. B. N. Juridike |
| Me porosi | |

Afati:

| | Normal (7 ditë) | | Prioritet (3 ditë) | | Urgjent (brenda ditës) | | Pa afat / për dijeni | Tjetër____ ditë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

**Data** 20.05.2024; **Nr. prot.** 1309/2. **Nënshkrimi (TITULLARIT)** ________

**Marrë në dorëzim** ___.___.2024. **Drejtori: Nënshkrimi** ________
**Kalon për trajtim (struktura):** ________ ___.___.2024.
**Me porosinë:** ________

**Marrë në dorëzim** ___.___.2024. **Përgjegjësi: Nënshkrimi** ________
**Kalon për trajtim (struktura):** ________ ___.___.2024.
**Me porosinë:** ________

**Marrë në dorëzim** ___.___.2024. **Specialisti: Nënshkrimi** ________
**Kalon për trajtim (specialistit):** ________ ___.___.2024.
**Me porosinë:** ________

**Trajtimi i materialit përfunduar më:** ___.___.2024, **Sp.** ________
**Trajtimi i materialit pranuar më:** ___.___.2024, **Përgj.** ________
**Trajtimi i materialit miratuar më:** ___.___.2024, **Drejt.** ________
**Trajtimi i materialit konfirmuar më:** ___.___.2024, **Dr.Kabineti** ________

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

DREJTORIA E VERIFIKIMIT TË FIGURAVE

Nr. 710/3 Prot. Tiranë, më 17.05.2024

**Lënda:** Informim mbi rezultatin e verifikimit të pastërtisë për kandidatin e propozuar për marrjen e titullit të nderit.

PROTOKOLLI
Nr. 1309/2
Dt. 20/05/2024

**KRYETARIT TË BASHKISË MALLAKSTËR**

I nderuar z. Ismailaj!

Në përgjigje të shkresës nr. 1309/1 prot., datë 26.04.2024, (tonën me nr. 710 prot., datë 29.04.2024), të Institucionit të Bashkisë Mallakastër "Kërkesë për informacion", drejtuar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti), për verifikimin e figurës në kuadër të dhënies së titullit të nderit z. Çelo Ramadan Boraj, kërkesë e Shoqatës Atdhetare Kulturore Mallakastra, bashkëlidhur do të gjeni:

Vendimin nr. 225, datë 14.05.2024 të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Sofi Noti**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

Adresa: Garnizoni "Skënderbej"
Rrugae Dibrës, Lagjia nr 10 Tiranë

www.autoritetidosjeve.gov.al
email:info@autoritetidosjeve.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

Nr. 783/12 Prot. Tiranë, më 17.05.2024

**V E N D I M**

**Nr. 20 Datë 14.05.2024**

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e datës 14.05.2024, me pjesëmarrjen e anëtarëve:

| | |
|---|---|
| Znj.Gentiana Sula | Kryetare |
| Z. Albert Nikolla | Anëtar |
| Z. Altin Hoxha | Anëtar |
| Z. Skënder Vrioni | Anëtar |

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Kërkesa e paraqitur nga Institucioni i Bashkisë Mallakastër, me shkresën nr. 1309/1 prot., datë 26.04.2024, "Kërkesë për informacion", për verifikimin e figurës së z. Çelo Ramadan Boraj, kandidat i propozuar për marrjen e titullit të nderit.

**BAZA LIGJORE:** Ligji nr. 45/2015 *"Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".*

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, pasi shqyrtoi kërkesën për informacion të paraqitur nga Institucioni i Bashkisë Mallakastër, me shkresën nr. 1309/1 prot., datë 26.04.2024, sipas objektit të saj,

**V Ë R E N:**

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" është përgjegjës për zbatimin e ligjit, lidhur me mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to.

Në nenin 10, pika "dh" të Ligjit nr. 45/2015, një nga detyrat e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit është edhe informimi i individëve, institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe subjekteve të tjera të interesuara, sipas këtij ligji.

Nga përmbajtja e shkresës nr. 1309/1 prot., datë 26.04.2024, "Kërkesë për informacion", Institucioni i Bashkisë Mallakastër në zbatim të detyrimeve ligjore që rjedhin nga Ligji nr. 45/2015 *"Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë"*, i ka kërkuar Autoritetit nëse disponon informacion, lidhur me z. Çelo Ramadan Boraj, kandidat i propozuar për marrjen e titullit të nderit të Bashkisë, me përmbajtje sipas shkresës së dërguar nga Bashkia Mallakastër. Mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm nga ana jonë, si dhe nga verifikimet e kryera deri tani referuar të dhënave të paraqitura nga institucioni kërkues, për z. Çelo Ramadan Boraj, rezulton të ketë materiale, në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në emër të tij në :

Adresa: Garnizoni "Skënderbej" Rrugae Dibrës, Lagjia nr 10 Tiranë
www.autoritetidosjeve.gov.al
email:info@autoritetidosjeve.gov.al

- Fondi nr. 4 Drejtoria e Parë e ish Sigurimit të Shtetit, viti 1979, dosje nr, 114 – Informacion dërguar ministrisë së Mbrojtjes Popullore mbi veprimtarinë keqbërëse e armiqësore në ushtri në gjysmën e dytë të vitit si dhe informacione mbi oficerin Çelo Boro në Gjirokastër.

Nga shqyrtimi i dosjes nr. 114 - Drejtoria e Sigurimit, Dega Sigurimi i Ushtrisë, rezulton : Shkresa nr. 194 prot, datë 16.01.1979, hartuar nga Drejtoria e Parë Dega e Sigurimit të Ushtrisë, me titull "Informacion mbi oficerin Çelo Boro Shef Shtabi i Korpusit të Gjirokastrës", ku pasqyrohet se "*dy të pandehur në hetuesi impikojnë edhe oficerin Çelo Boro për qëndrim imoral*". Shkresa konceptohet dhe nënshkruhet nga Kryetari i Degës së Sigurimit në Ushtri.

**PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në nenin 10, nenin 26 e vijues të ligjit nr. 45/2015 "*Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*", ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 "*Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike*", Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

**VENDOSI**

1.Të informojë Institucionin e Bashkisë Mallakastër, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 1309/1 prot., datë 26.04.2024, "Kërkesë për informacion", në kuadër të propozimit për marrjen e titullit të nderit të Bashkisë, se nga verifikimet e kryera deri tani, sipas përcaktimeve të nenit 30 të Ligjit nr. 45/2015 "*Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*", i ndryshuar rezulton se z. Çelo Ramadan Boraj,:

a) Nuk ka qenë anëtar ose kandidat i Byrosë Politike, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, Kryetar i Gjykatës së Lartë, Prokuror i Përgjithshëm, Kryetar i Hetuesisë së Përgjithshme, anëtar i Këshillit të Ministrave, kryetar i degëve të punëve të brendshme, anëtar i Komisionit Qendror të Dëbim Internimeve, hetues, prokuror, gjyqtar në procese posaçme politike, apo punonjës i nivelit të lartë i ish-Sigurimit të Shtetit;
b) Nuk ka qenë bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, denoncues në proceset politike ose dëshmitar i akuzës në proceset politike të posaçme, pas mbushjes së moshës 18 vjeç;
c) Nuk ka qenë person me të dhëna nga ish-Sigurimi i Shtetit për spiunazh dhe terrorizëm.

2. Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet institucionit të Bashkisë Mallakastër.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit.

**KRYETARJA**

**Dr. Gentiana Sula**

| **ANËTAR** | **ANËTAR** | **ANËTAR** |
|---|---|---|
| **Dr. Albert Nikolla** | **Altin Hoxha** | **Skënder Vrioni** |

Adresa: Garnizoni "Skënderbej"
Rruga e Dibrës, Lagjia nr. 10 Tiranë
www.autoritetidosjeve.gov.al
email:info@autoritetidosjeve.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALLAKSTËR**

**KOMISIONI**

Nr.4141 prot. Ballsh më21.08.2024

# RELACION

**Drejtuar** : Këshillit Bashkiak Mallakastër ,autoriteti përgjegjës vendor për dhënien e titujve të nderit.

**Të nderuar anëtar të Këshillit Bashkiak,**

Komisioni Këshillimor për Dhënien e Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Mallakastër ,i ngritur me urdhër Nr.126, datë 16.04.2024, të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, i përbërë nga Znj.Rajmonda Veizaj, Znj.Burbuqe Shehaj, Znj.Zinaida Ahmetaj, Znj.Naime Dervishaj, Znj.Jonida Llaka dhe mbështetur ne nenin 54 gërma "m" e Ligjit 139/2015,datë 17.12.2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", Ligjit 112/2013 "Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë" me propozim të Shoqatës Atdhetare Kulturore Mallakastra, për dhënien e titullit "Qytetar Nderi",

*Të Z.Çelo Boraj.*

Pas shqyrtimit të propozimit dhe shkresës Nr. 1309/1 prot., datë 26.04.2024, 'Kërkesë për informacion', drejtuar Autoritetit për Informim mbi Dokumetet e ish-Sigurimit të Shtetit, për verifikimin e figurës në kuadër të dhënies titull të nderit z. Çelo Boraj,dhe sipas shkresës Nr.1309/2 prot., datë 20.05.2024, 'Informim mbi rezulatin e verifikimit të pastërtisë për kandidatin e propozuar për marrje titull të nderit';

Komisioni paraqet mendimin e tij si më poshtë:

- Dhënia e titujve është një vlerë e shtuar në historinë e dhënies së titujve të qytetit tonë, pasi roli dhe kontributi përkatësisht i z.Çelo Boraj lindur më 08.05.1943 në Rromës të mallakastrës, ardhur nga një familje ku u edukua me traditat e vyera Mallakastriote, duke përcjell dashurinë për atdheun dhe familjen.
- Nga vitet 1960 deri më 1963: Shkolla e Bashkuar e Oficerëve 'Enver Hoxha', Tiranë ka mbajtur gradën 'Toger'.
- Në vitet 1963 deri më 1967 z. Çelo Boraj ka mbajtur detyrën e: Komndant Toge, Zv.Kom/Kompanie, Komandant Batalioni në Buz, Tepelenë; dhe në Përmet.

- Në vitet 1969 deri më 1992 ka kryer detyra ushtarake nga më të lartat, nga jugu në veri të Shqipërisë, si komandant Brigade, Shef Shtabi të Korpusit, komandant Divizioni, etj.
- Komisioni Shpreh konsidertaën më të lartë për këtë figurë të rëndësishme për shoqërinë tonë duke dhënë vlerësimin pozitiv për këtë propozim ,i sugjerojmë Këshillit Bashkiak miratimin e dhënien e titullit "Qytetar Nderi" për: ***Z.Çelo Boraj.***

"QYTETAR NDERI"

**KOMISIONI:**

Rajmonda Veizaj

Burbuqe Shehaj

Zinaida Ahmetaj

Naime Dervishaj

Jonida Llaka